Kronikë

'Tempulli'/ Operacion antidrogë në gjithë vendin, 67 urdhër arreste të ekzekutuara në Tiranë, arrestime dhe ne qytete të tjera! Sekuestrohet kokainë, kanabis e armë

Një tjetër operacion është zhvilluar në të gjithë vendin kundër ti luftës kundër lëndëve narkotike. Burime bëjnë me dije se janë mbi 165 të arrestuar, 100 prej tyre në Tiranë. Ndërkohë, është sekuestruar edhe drogë e ndarë në doza gati për shitje, por ende nuk dihet sasia.

- 35 të arrestuar në Vlorë, sekuestrohet kokainë
- Rreth 20 të arrestuar në Elbasan
- 10 të arrestuar në Korçë, disa shoqërimë! Hetime prej 3 muajsh

Foto Ilustrative

Sokol Dema
22 Janar, 07:14 | **Përditësimi: 22 Janar, 10:22**

Share

Një tjetër operacion mbanë kombëtar është zhvilluar në kuadër të luftës kundër lëndëve narkotike. Peshën më të madhe e mbanë sërish Antidroga e Policisë së Tiranës. Sipas informacioneve, deri më tani janë lëshuar 89 urdhër arreste në Tiranë, ku 67 prej tyre janë ekzekutuar dhe 22 të tjerë janë ende në kërkim. Mësohet se është sekuestruar 5 kg kokainë, 14 kg kanabis e 5 armë zjarri.

Ky është vazhdimi i operacionit 'Tempulli' dhe hetimet po drejtohen nga Prokuroria e Tiranës. Shqëndarja e lëndëve narkotike bëhej afër shkollave, në lokale të natës dhe vende të tjera publike.

Në qytetin e Vlorës raportohet se janë 35 të arrestuar, ndërsa është sekuestruar edhe kokainë e ndarë në doza, gati për shitje. Në Korçë 10 persona kané rënë në pranga dhe disa janë shoqërisur, ndërsa në Elbasan raportohet për rreth 20 arrestime.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
'Pedalojmë të sigurt', pasdite ndryshe te "Ali Demi"! Familjet, lojë dhe informacion për sigurinë rugore

Antidroga prej kohësh ka nisur hetimet për gjoditjen e disa grupeve kriminale të cilët merren me shitje dhe trafik të drograve të forta dhe të lehta. Policia ende nuk ka dalë me një komunikim zyrtar mbi këtë operacion.

Redaksia e Report Tv po punon për të mësuar më shumë detaje...

Rendit zhvillimet sipas orarit: 16 Fundit

Ora 10:19

Operacioni antidrogë, lëshohen 89 masa sigurie, 67 prej tyre të ekzekutuara! Sekuestrohet kokainë, kanabis e armë zjarri

Report Tv sjell të tjera detaje nga operacioni antidrogë në qytetin e Tiranës. Burime për gazetarin e Report Tv, Sokol Dema bëjnë me dije se deri më tani janë lëshuar 89 masa sigurie, ku 67 prej tyre janë ekzekutuar dhe 22 të tjerë janë ende në kërkim.

Mësohet se është sekuestruar 5 kg kokainë, 14 kg kanabis e 5 armë zjarri.

SI E /Shqiptarja.com

Share

Ora 08:52

Operacioni antidrogë, rreth 20 të arrestuar në Elbasan

Foto Ilustrative

Një operacion antidrogë është zhvilluar në gjithë vendin.

Report Tv mësoi se rreth 20 persona kané rënë në pranga në Elbasan, në kuadër të këtij operacioni që është vijimësi e 'Tempullit'.

SI E /Shqiptarja.com

Share

Ora 08:31

Operacioni antidrogë, 10 të arrestuar në Korçë, disa të shoqëruar! Hetime prej tre muajsh

Operacioni antidrogë është shtrirë është në qytetin e Korçës. Burime për gazetarin e Report Tv, Armand Braho bëjnë me dije se janë shoqëruar dhjetëra shtetas dhe janë kryer gjithashtu dhjetëra arrestime. Aksioni ka nisur që prej ditës së djeshme dhe është finalizuar sot.

Burime nga policia thonë se në këtë operacion janë arrestuar mbi 10 persona dhe janë shoqëruar në komisariat shumë të tjerë.

Policia shpjegon se ka qenë një hetim pro aktiv 3 mujor i Prokurorisë së Korçës në bashkëpunim me Policinë, çka ka rezultuar me lëshimin e urdhër-arrestevE të kityre personave si edhe shoqërirme të personave të tjerë që mund të procedohen në gjendje të lirë.

SI E /Shqiptarja.com

Share

Ora 07:45

Operacioni antidrogë, 35 të arrestuar në Vlorë, sekuestrohet kokainë



Foto Ilustrative

Një operacion anti-drogë po zhvillohet në të gjithë vendin, i cili është vijimësi i megaoperacionit 'Tempulli'.

Burime për gazetarin e Report Tv, Armand Xhelili bëjnë me dije se në kuadër të këtij operacioni në qytetin e Vlorës janë arrestuar 35 persona.

Po ashtu, janë sekuestruar edhe doza kokaine gati për shitje, por ende nuk bëhet me dije sasia.

SI E /Shqiptarja.com

Share

SI E /Shqiptarja.com

TAG: Megaoperacioni Tempulli Tiranë

Komentoj

Ndalohet mepërdashit riqëndikimi i kërkë shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
13 vitte nga vrasja e 4 protestuesve, a duhet SPAK të hetojë 21 janarin?

Po Jo Nuk e di

Lajmi të tjera

'El Debate': Shqipëria mes destinacioneve më interesante për të udhëtuar në 2024-ën! Tirana, qytet i gjallë me një historri të pasur

21 Janar, 16:59

'Kërkojnë t'u vjedhin të dhënat', policia thirrje përdoruesve të 'iphone': Kujdes nga mesazhet mashtruese që u vijnë në celular

21 Janar, 15:02

Nga Talat Xhaferri te Ylli Ujka, shpallen fituesit e CCIT AWARDS, Nëntëryetari Seferi: Biznesi aksioner në suksesin e Tiranës

20 Janar, 22:10

Basketboll/ Tirana fiton me diferencë ndaj Besëlidhjes dhe ngre trofeun e 20-të të Kupës së Shqipërisë

20 Janar, 21:41

Dy helikopterë britanikë nesër spektakël në qiellin e Tiranës

20 Janar, 21:21

GOLAT/ Laçi përmbys 1-2 Partizanin në kryeqytet, në Korçë shfryhet ndeshja! Vllaznia mposht 0-1 Erzenin 'in-extremis', Osmani goditet në kokë

20 Janar, 19:10

Skanderbeg VIP Longe në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës- imbarkohuni në një udhëtim luksi dhe këndaqësie

20 Janar, 15:35

'Po më ka, do ti vë flakën 'Audit'!' Ish i dashuri nga Zvicra urdhëroi djegjen e makinës së ish-partneres në Astir! Në kërkim 2 maqedonas

Sokol Dema

20 Janar, 14:38

Tiranë/ Arrestohet çifti me celularë e ilaçe kontrabandë (EMRAT)

20 Janar, 12:11

Begaj takim me sipërmarrës në Shijak: Investimet e ndershme zhvillojnë Shqipërinë

20 Janar, 11:49

EMRAT/ Dogjën ekskavatorin e një gurorje me vlerë 150 mijë euro, arrestohen dy të rinjtë nga Zall-Herri

20 Janar, 11:31

Vodhën rreth 10 mijë euro në vendin ku ishin punësuar, arrestohen persona të Tiranë

20 Janar, 09:56

Lajmi i fundit

FOTOLAJM/ Kurti ulet krah Ramës në takimin në Shkup! Në tyrezë edhe Vuçiç

22 Janar, 10:27

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje